URDHËR
Nr. 150, datë 26.6.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 12, pika 1, dhe nenit 13, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 7, pika 2, germa "c", të rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit gjyqtares Mimoza Tasi, për periudhën 2.7.2025–4.7.2025. Kjo kompetencë nuk mund të nëndelegohet.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet gjyqtarja Mimoza Tasi dhe të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo